



Rr. "Zija Shemsiu" pn
Gjiilan, Kosovë
E-mail: info@uni-gjiilan.net
Tel: +381280390112

18.11.2023



kutia

St. Prekazi, Prishtinë,
www.kutia.net
E-mail: info@kutia.net

 academy

Str. Anton Çetta, no. 29
Prishtinë, Kosovë
E-mail: xk@beetroot.academy
Tel: +383 (0)48 248 788

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ky Memorandum bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

Beetroot Academy SH.P.K., me numër identifikues 811403534, Rr. Anton Çetta, no. 29, Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga Merita Çeku;

Universiteti Publik KADRI ZEKA, me adresë në rrugën Zija Shemsiu, p.n., Gjiilan, Kosovë përfaqësuar nga Rektori Z. Artan Dërmaku; dhe

Kutia, me numër identifikues 810827727, Rr. Prekazi, nr. 5-1, Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga Arianit Fazliu.

Beetroot Academy, Universiteti Publik Kadri Zeka dhe Kutia në vijim do të quhen bashkërisht si "Palët" dhe secila veçmas si "Palë e Parë", "Palë e Dytë" dhe "Palë e Tretë".

Ndërsa, palët e lartpërmendura hyjnë në marrëveshjen e bashkëpunimit të përshkruar në këtë Memorandum Bashkëpunimi, në të cilën do të punojnë së bashku për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara;

Palët bien dakord të bashkëpunojnë si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është të sigurojë një kornizë bashkëpunimi i cili ka për qëllim zhvillimin e të rejave të komunës së Gjiilanit në fushën e IT-së, fushë kjo me interes të përbashkët që krijon mundësi pune dhe rritje të njohurive në këtë fushë.

Përmes programit "**Women in Tech**" synohet të ofrohen 24 bursa për studentet e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në Universitetin Publik Kadri Zeka në Gjiilan, me fokus të veçantë në studentet e interesuara për të ndjekur një karrierë në teknologji.

Neni 2
Përgjegjësitë e Beetroot Academy

Përmes këtij Memorandumi Bashkëpunimi, Pala e Parë pajtohet të:

2.1 Ofrojë edukim dhe trajnime cilësore për 24 studente të përzgjedhura nga Universiteti Publik Kadri Zeka në Gjilan përmes programeve të trajnimit në fushën e IT-së të cilat nuk ofrohen në Programet Studimore në Fakultet të Shkencave Kompjuterike, si mjet shtesë për përgatitjen e tyre në tregun e punës dhe të zhvillimit të karrierës;

Neni 3
Përgjegjësitë e Universiteti Publik Kadri Zeka

Përmes këtij Memorandumi Bashkëpunimi, Pala e Dytë pajtohet të:

- 3.1 Të përzgjedhë studentet e dalluara për të ndjekur trajnimet;
- 3.2 Të sigurojë hapsira adekuate dhe të pajisura me kompjuterë ku studentet mund të ndjekin trajnime në fushën e IT-së dhe ku Pala e Parë mund të zhvillojë këto trajnime;
- 3.3 Të ofrojë ndihmë teknike dhe logjistike për sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm për trajnimet.

Neni 4
Përgjegjësitë e Kutia

Përmes këtij Memorandumi Bashkëpunimi, Pala e Tretë pajtohet të:

4.1 Të ofrojë 24 bursa për studentet e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të cilat do të përfshihen në programin "Women in Tech", duke ofruar mbështetje financiare dhe mundësi për zhvillim profesional.

Neni 5
Përgjegjësitë e përbashkëta

- 5.1 Palët nënshkruese zotohen për realizimin e kësaj marrëveshje në mirëbesim, duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet të cilat i kanë në dispozicion për përmbushjen qëllimeve të memorandumit.
- 5.2 Palët do të shkëmbejnë informacione dhe do të japin të dhëna të tjera të nevojshme në përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara dhe poashtu zotohen të organizojnë sipas nevojës takime dhe forma tjera të shkëmbimit të njohurive;
- 5.3 Palët në pajtim të ndërsjellë mund të parashikojnë edhe forma të tjera të bashkëpunimit që kanë për synim zhvillimin e projekteve në fushat e interesit të përbashkët; Palët do të vënë në dispozicion të gjitha resurset e nevojshme për realizimin bashkëpunimit;



Rr. "Zija Shemsiu" pn
Gjiilan, Kosovë
E-mail: info@uni-gjiilan.net
Tel: +381280390112



St Prekazi, Prishtinë,
www.kutia.net
E-mail: info@kutia.net



Str. Anton Çetta, no. 29
Prishtinë, Kosovë
E-mail: xk@beetroot.academy
Tel: +383 (0)48 248 788

5.4 Palët me marrëveshje të ndërsjellë dhe në mirëkuptim do të realizojnë qëllimet e memorandumit dhe format e tjera të bashkëpunimit që mund të lindin në të ardhmen;

5.5 Palët dakordohen që për çdo çështje të kontaktojnë (emailet respektive të palëve) përfaqësuesit e autorizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë;

5.6 Detyrimet e përcaktuara në këtë marrëveshje do të jenë pjesë e diskutimeve dhe e zgjerimeve të mëtejshme dhe palët nuk kanë asnjë detyrim paraprak për realizimin e secilës pikë. Palët me mirëbesim realizojnë këtë marrëveshje duke mbrojtur dhe duke mos dëmtuar imazhin e njëra-tjetres.

Neni 6 Kohëzgjatja e Memorandumit

6.1 Ky Memorandum është lidhur për 12 muaj, nga data e nënshkrimit dhe me mundësi të vazhdimit.

6.2 Secila Palë mund të shkëputet nga ky Memorandum. Në rast se njëra nga palët dëshiron të shkëputet nga ky memorandum, atëherë ajo do të njoftoj palën tjetër me shkrim në afat prej 30 ditësh para shkëputjes.

Neni 7 Dispozitat përfundimtare

Të gjitha informacionet me shkrim dhe me gojë dhe materialet e shpalosura ose të siguruar nga secila prej Palëve do të konsiderohen si konfidenciale edhe nëse informacioni i tillë është dhënë para ose pas datës së nënshkrimit të këtij Memorandumi Bashkëpunimi.

Neni 8 Hyrja në fuqi

8.1 Ky Memorandum Bashkëpunimi është hartuar në dy kopje origjinale dhe secila nga palët nënshkruese e mban nga një kopje;

8.2 Memorandumi i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe protokollimit nga palët. Si dëshmi e kësaj, përfaqësuesit e palëve të autorizuara vendosin nënshkrimin e tyre më poshtë.

Beetroot Academy

M. Selman
Nënshkrimi

13.11.2023
Data:

Kutia

Albani

Nënshkrimi

Data:

Universiteti Publik Kadri Zeka

Jemil
Nënshkrimi

13.11.2023
Data:

